



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 170, datë 17.3.2021

P Ë R

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.7, DATË 6.1.2020, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, "PËR KUSHTET DHE PROCEDURËN
PËR SHPRONËSIMET DHE/OSE SHKËMBIMIN E PRONËS,
PËR INTERES PUBLIK, NË FUNKSION TË PROCESIT
TË RINDËRTIMIT"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 32, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.97/2019, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Pika 6, e kreut II, të vendimit nr.7, datë 6.1.2020, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6. Prona private, njësi tregtimi:

- a) pronarët privatë, që kanë në pronësi njësi tregtimi në zonën e re për zhvillim, kompensohen me vlerë në masën që përlllogaritet nga komisioni i shpronësimit, duke iu referuar çmimeve që zbatohen në procedurat për shpronësimin, për interes publik, sipas legjislacionit në fuqi; ose
- b) me pëlqimin e tyre, pronarët privatë që kanë në pronësi njësi tregtimi në zonën e re për zhvillim, kompensohen nëpërmjet shkëmbimit të Së drejtës së pronësisë mbi njësinë e tregtimit me fitimin e pronësisë mbi një njësi banimi ose njësi tregtimi, nëse ka, me të njëjtën sipërfaqe në metër katror sa njësia e tregtimit që kishin në pronësi;
- c) në rast se, për shkak të strukturës së njësisë së tregtimit, njësisë së banimit ose shtëpisë individuale të banimit në zonën e re, rezultojnë

sipërfaqe shtesë në pronën me të cilën kompensohet, pronari privat paguan për çdo metër katror shtesë çmimin e miratuar me vendim nga Enti Kombëtar i Banesave në fuqi në kohën e shpronësimit ose të shkëmbimit. Në rast se, për shkak të strukturës së njësisë së tregtimit, njësisë së banimit ose shtëpisë individuale të banimit në zonën e re rezultojnë sipërfaqe më të vogla, në pronën me të cilën kompensohet, pronari privat ka të drejtë të kompensohet, për pjesën e mbetur të sipërfaqes, në përputhje me shkronjën “a”, të kësaj pike.”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ministri i Shtetit për Rindërtimin, njësitë e vetëqeverisjes vendore, njësitë zbatuese dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ERION BRACE

**MINISTRI I SHITETIT
PËR RINDËRTIMIN**

ARBEN AHMETAJ

NR.PROT. 1440/1
DATË 18.3. 2021

MINISTRIT TË SHTETIT PËR RINDËRTIMIN
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE
ENERGJISË
AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS
TË GJITHA BASHKIVE
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI

A handwritten signature in black ink is written over a blue circular official stamp. The stamp contains the text "REPUBLIKA E SHQIPËS" and "MINISTRI I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË" around a central emblem.